REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 539/23
Datë/Datum. 17.05.2023
PRISHTINE - PRIŠTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.686/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit N.T.P. "Air Tours" me seli në Suharekë, rr. "Hajdin Berisha" p.n, me numër unik identifikues 810630766, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Florent Sallahu nga Suhareka, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, rr. "Migjeni", për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr.671/22, të datës 03.02.2021 i ndryshuar dhe plotësuar me konkluzionin PSH.nr.671/22 i datës 06.02.2023 i nxjerrë nga OSHP, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit-propozuesit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë,- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.122/23, të datës 27.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 10.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit-propozuesit "N.T.P. "Air Tours" me seli në Suharekë, rr. "Hajdin Berisha" p.n, me numër unik identifikues 810630766, e datës 18.04.2023, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr. 122/23, të datës 27.03.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktvendimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: REFUZOHET si e pabazuar

REPUBLIKA E KOSOVËS GJYKATA KOMERCIALE KOMERCIJALNI SUD REPUBLIKA KOSOVA

kërkesa e paditësit N.T.P "Air Tours", me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit PSH.nr.671/22 i datës 03.02.2023 i ndryshuar dhe plotësuar me konkluzionin PSH.nr.671/22 i datës 06.02.2023, të nxjerrë nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

Kundër këtij Aktvendimi, ka ushtruar ankesë paditësja, me të cilën e ka kundërshtuar Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkaqeve të kuptuara nga referati i ankesës, duke propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditëses dhe aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative ta anuloj a po cështjen ta kthej në rivendosje.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar kërkesën e paditësit/propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që paditësi nuk ka argumentuar se ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohej, si dhe nuk ka argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së. Pra, paditësi nuk e ka mbështetur në ndonjë provë kërkesën e tij për shtyrje të ekzekutimit të vendimit ashtu që të njëjtën nuk e ka bërë të besueshme mbi ndonjë bazë reale se ekzekutimi i vendimit paditësit do ti sillte ndonjë dëm vështirë të riparueshëm.

Gjykata po ashtu vlerësoi se me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit do të pezullohej aktiviteti i prokurimit "Furnizim me material hidrosanitari – ndriçim-elektrikë etj, për Administratë, QKMF dhe shkolla" me numër të prokurimit 624-22-3122-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna Suharekë, deri në vendosjen përfundimtare të gjykatës, ashtu që do ti pamundësonte

REPUBLIKA E KOSOVËS GJYKATA KOMERCIALE KOMERCIJALNI SUD REPUBLIKA KOSOVA

autoritetit kontraktues që të zhvillojë procedurë tjetër tenderuese për furnizimin me material hidrosanitari – ndriçim-elektrikë në atë mënyrë që të njëjtat pastaj të shpërndahen në Administratë, QKMF dhe shkolla, veprim ky që do ishte në kundërshtim me interesin publik.

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 22.2 dhe 6, i Ligjit për Konfliktin Administrativ, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues. Këtë vlerësim gjykata e shkallës së parë e mbështet në faktin se paditësi nuk ka ofruar prova të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do ti sillte dëm paditësit i cili dëm vështirë do të riparohej.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Edhe kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë njëjtë si gjykata e shkallës së parë vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit paditësit nuk do t'i sillte dëm i cili vështirë do të riparohej si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Pretendimet ankimore të palës paditëse, të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës siç pretendon e paditura në ankesë. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA KOMERCIALE
KOMERCIJALNI SUD
REPUBLIKA KOSOVA

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkalllës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, rr. "Migjeni", dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar.

Meqë në këtë rast paditësja në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme me asnjë provë pretendimet e saj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm. Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.686/23, data 10.05.2023

Kryetarja e kolegjit-Saranda Bogaj Sheremeti, d.v

Republika e Kosovës Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST KOPIJE POTVRĐUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA KOMERCIALE
KOMERCIJALNI SUD
REPUBLIKA KOSOVA